

PHILIPS

Radio interneti

M2805



Manuali i përdorimit

Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në
www.philips.com/support

Përmbajtja

1	E rëndësishme	2
	Siguria	2
	Siguria për dëgjimin	2
2	Radioja juaj e internetit	3
	Hyrje	3
	Çfarë ka në kuti	3
	Përmbledhje e njësisë kryesore	3
	Përmbledhje për telekomandën	4
3	Fillimi	5
	Lidhja e antenës së radios	5
	Lidhja me energjinë	5
	Vendosja e produktit	5
	Përgatitja e telekomandës	6
	Ndezja	6
	Konfigurimi fillestar	6
4	Dëgjimi i radios me internet	8
	Përdorni menunë në listën e stacioneve në modalitetin e radios me internet	8
	Ruajtja e stacioneve të radios së internetit	9
	Zgjedhja e një stacioni radioje interneti	9
	Shfaqja e informacioneve të stacionit të radios me internet	9
5	Dëgjimi i Spotify	9
6	Dëgjimi i radios DAB	10
	Kalimi nëpër stacionet DAB	10
	Për të shkuar në një stacion në listën e stacioneve të disponueshme	10
	Ruajtja e stacioneve të radios DAB	10
	Zgjedhja e një stacioni radioje DAB	10
	Zgjedhja e menusë DAB dhe shfaqja e informacionit	10
	Shfaq informacionet e DAB+	11
7	Dëgjimi i radios FM	11
	Kalimi nëpër stacionet FM	11
	Ruajtja e stacioneve të radios FM	11
	Zgjedhja e një stacioni radioje FM të caktuar paraprakisht	12
	Përdorimi i menusë në modalitetin FM	12
	Shfaqja e informacioneve RDS	12
8	Luajtja nga pajisjet me Bluetooth	13
9	Përdorimi i menusë së parametrave të sistemit	13
	Vendosja e gjuhës së sistemit	14
	Rregullimi i parametrave të rrjetit	14
	Vendosja e orës dhe datës	14
	Rivendosja e të gjitha parametrave	14
	Shikimi i informacioneve të rrjetit dhe përditësimi	14
	i firmuerit (nëse ka)	14
	Shikimi i versionit të softuerit	15
	Rregullimi i ndriçimit	15
10	Përdorimi i menusë kryesore të sistemit	15
	Vendosja e orës dhe alarmit	15
	Vendosja e kohëmatësit të gjumit	16
11	Informacione për produktin	17
12	Zgjidhja e problemeve	17
13	Njoftim	18
	Deklarata e konformitetit	18
	Kujdesi për mjedisin	18

I E rëndësishme

Siguria

Duhet t'i lexoni dhe t'i kuptoni të gjitha udhëzimet para se ta përdorni produktin. Nëse shkaktohet ndonjë dëmtim nga mosndjekja e udhëzimeve, garancia është e pavlefshme.



Kjo shenjë rrufeje tregon se brenda pajisjes ka material të paizoluar, i cili mund të shkaktojë goditje elektrike. Për sigurinë e të gjithëve në familjen tuaj, ju lutemi mos e hiqni kapakun. "Pikëçuditja" tërheq vëmendjen ndaj veçorive për të cilat duhet të lexoni me kujdes literaturën e dhënë me qëllim që të parandalohen problemet e përdorimit dhe mirëmbajtjes.

PARALAJMËRIM: Për të pakësuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, pajisja nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështisë, dhe objektet me lëngje, siç mund të jenë vazot nuk duhen vendosur mbi këtë pajisje.

KUJDES: Për të parandaluar goditjet elektrike, futeni spinën plotësisht. (Për zonat me spina të polarizuara: Për të parandaluar goditjet elektrike, futeni kunjën e gjerë në vrimën e gjerë.)



Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e këtij aparati.
- Asnjëherë mos lubrifikoni asnjë pjesë të këtij aparati.
- Asnjëherë mos e vendosni këtë aparat mbi pajisje të tjera elektrike.
- Mbajeni aparatin larg nga drita direkte e diellit, flakët e ndezura ose nxehtësia.
- Sigurohuni që ta arrini gjithnjë me lehtësi kordonin e energjisë, spinën ose adaptorin për ta shkëputur aparatin nga energjia.

- Pajisja nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.
- Mos vini asnjë burim rreziku në pajisje (p.sh. objekte të mbushura me lëng, qirinj të ndezur).

- Aty ku spina e energjisë ose një bashkues i pajisjes përdoret për si mjet shkëputjeje, pajisja e shkëputjes duhet të jetë në një vend që arrihet me lehtësi.
- Sigurohuni që të ketë hapësirë të lirë të mjaftueshme anembanë produktit për ajrim.
- **KUJDES** lidhur me përdorimin e baterisë - Për të mos lejuar rrjedhjet e baterive të cilat mund të shkaktojnë lëndime, dëmtime të pronës, ose dëmtime të aparatit.
- Vendosini bateritë me polaritetin e duhur, siç tregohet.
- Bateritë (të paketuara ose të instaluar) nuk duhet të ekspozohen në nxehtësi ekstreme si drita e diellit, zjarri ose të ngjashme.
- Hiqini bateritë kur aparati nuk do të përdoret për kohë të gjatë.
- Përdorni vetëm pjesë / aksesore që janë specifikuar nga prodhuesi.



Kujdes

- Për të shmangur dëmtimin në dëgjim, kufizoni kohën që e përdorni kufjet me volum të lartë dhe vendoseni volumin në një nivel të sigurt.
- Sa më i lartë të jetë volumi, aq më e shkurtër të jetë koha e dëgjimit.

Siguria për dëgjimin

Sigurohuni të ndiqni udhëzimet e mëposhtme kur përdorni kufjet.

- Dëgjoni me volum të arsyeshëm për periudha kohe të arsyeshme.
- Bëni kujdes të mos e rritni vazhdimisht volumin ndërsa mësoheni me dëgjimin.
- Mos e ngrini volumin kaq shumë saqë të mos dëgjoni çfarë ka rreth jush.
- Duhet të bëni kujdes ose të mos e përdorni përkohësisht në situata që mund të jenë të rrezikshme.
- Presioni i tepërt i tingullit nga kufjet mund të shkaktojë humbje të dëgjimit.

2 Radioja juaj e internetit

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni produktin në www.philips.com/support.

Hyrje

Me këtë pajisje ju:


- mund të dëgjoni radio interneti me anë të lidhjes së rrjetit.
- mund të dëgjoni radio me transmetim FM dhe Digital Audio Broadcasting (DAB).
- Luani audio nga pajisjet me Bluetooth.
- Përdorni telefonin, tabletën ose kompjuterin si telekomandë për Spotify.
- Shikoni orën dhe vendosni një alarm.

Çfarë ka në kuti

Kontrolloni dhe dalloni gjërat që ka në kuti:

- Njësia kryesore
- Mbajtëse tavoline
- 1 x adaptor energjie AC
- 1 antenë radioje
- Telekomandë (me 2 bateri AAA)
- Materialet e shtypura

Përmbledhje e njësisë kryesore




① Sensor IR

② Treguesi LED

- Treguesi standby: bëhet i kuq kur produkti kalon në standby.

③ Ekran

- Shfaqni statusin aktual.



④

- Priza e kufjeve.

⑤ AUX IN

- Lidhni një pajisje audio të jashtme.

⑥

- Ndezja ose vendosja në gjendje pritjeje.

⑦

- Shtypni për të zgjedhur një burim: FM, DAB+, AUDIO IN, BT.
- Në modalitetin Bluetooth, mbajeni shtypur për më shumë se 2 sekonda për të hyrë në modalitetin e çiftimit.

⑧ MENU /


- Shkoni te menuja kryesore.

⑨ PRESET

- Zgjidhni një stacion radioje me internet, stacion radioje FM stacion DAB+ të ruajtur paraprakisht.

- ⑩ **SELECT / ►►**
 - Konfirmimi zgjedhjen.
- ⑪ **INFO / **
 - Shfaq informacion.
 - Rregulloni ndriçimin.
- ⑫ **SLEEP/ALARM**
 - Vendosni opsionet e alarmit dhe gjumit.
- ⑬ **◀◀ / TUNE —**
 - Kaloni te kënga e mëparshme;
 - Kthehuni te stacioni i mëparshëm i radios.
- ⑭ **TUNE + / ►►**
 - Kaloni te kënga tjetër;
 - Kaloni te stacioni tjetër i radios.
- ⑮ **VOL — dhe VOL +**
 - Rregullimi i volumnit.
- ⑯ **MUTE**
 - Heshtja e volumnit.
- ⑰ **ANT**
 - Lidhuni me antenën e radios.
- ⑱ **DC IN JACK**
 - Lidhuni me adaptorin e energjisë.

Përmbledhje për telekomandën



- ① ****
 - Ndezja ose vendosja në gjendje pritjeje.
- ② ****
 - Shtypni për të shkuar te menuja grafike kryesore.
 - Radio interneti, Spotify, radio DAB, radio FM, modaliteti BT, modaliteti AUX IN.
 - Shtypeni dhe mbajeni shtypur për të kaluar te modaliteti BT.
- ③ ****
 - Shfaqni informacionet e lajtjes ose informacionet e shërbimit të radios.
- ④ ****
 - Zgjidhni një stacion FM.
 - Zgjidhni një stacion DAB+.
 - Programoni stacionet e radios.
 - Ruani automatikisht stacionet e radios.
 - Rregullimi i volumnit.
 - Zgjidhni një burim AUDIO IN.
- ⑤ ****
 - Zgjidhni një stacion radioje të ruajtur paraprakisht.
- ⑥ ****
 - Kthehuni te menuja e mëparshme.
- ⑦ **SOUND / DBB**
 - Zgjidhni një efekt zëri të ruajtur paraprakisht.
 - Aktivizoni ose çaktivizoni DBB.
- ⑧ ****
 - Vendosni një kohëmatës alarmi.
- ⑨ ****
 - Vendosni një kohëmatës gjumi.
- ⑩ ****
 - Rregulloni ndriçimin.
- ⑪ ****
 - Heshtni ose riktheni volumnin.

3 Fillimi



Kujdes

- Përdorimi i kontrolleve ose bërja e rregullimeve, apo kryerja e procedurave të tjera që nuk janë përmendur këtu mund të shkaktojë ekspozim të rrezikshëm ndaj rrezatimit dhe funksionime të tjera të pasigurta.

Ndiqni gjithnjë me radhë udhëzimet në këtë kapitull.


Nëse kontaktoni Philips, do të pyeteni për numrin e modelit dhe të serisë së këtij produkti.

Nr. i modelit. _____

Nr. i serisë. _____


Lidhja e antenës së radios

Lidhni antenën e radios me këtë produkt para se të dëgjoni radion.



Lidhja me energjinë

Lidhni kordonin e energjisë me prizën në mur.



Kujdes

- Rrezik i dëmtimit të produktit! Sigurohuni që tensioni i energjisë përputhet me tensionin që tregohet mbrapa ose poshtë pajisjes.
- Rrezik goditjeje elektrike! Para se të lidhni adaptorin e energjisë AC, sigurohuni që konverteri i spinës së adaptorit të jetë fiksuar mirë. Kur shkëputni adaptorin e energjisë AC, tërhiqni gjithnjë spinën nga priza.
- Para se të lidhni adaptorin e energjisë AC, sigurohuni që të keni bërë të gjitha lidhjet e tjera.


Vendosja e produktit

Para se ta vendosni produktin mbi tavolinë, lidhni mbajtësen për tavolinë me aparatit, siç tregohet në figurën e mëposhtme.



Këshillë

- Shikoni dokumentin e bashkëngjitur për montimin në mur për të mësuar si ta montoni këtë produkt në mur.



Përgatitja e telekomandës




Kujdes


- Rrezik i dëmtimit të produktit! Kur telekomanda nuk do të përdoret për periudha të gjata, hiqni bateritë.
- Përmblajnë substanca kimike, ndaj duhet të hidhen si duhet.

Për të futur bateritë e telekomandës:


- 1 Hapni kapakun e pjesës së baterive.



- 2 Vendosni 2 bateritë AAA me polaritetin e duhur (+/-) siç është shënuar.



- 3 Mbylleni kapakun e pjesës së baterive.



Ndezja

Shtypni

- ↳ Kur pajisja është e ndezur, ajo shkon në burimin e zgjedhur për herë të fundit.

Për të kaluar në modalitetin në pritje, shtypni

- ↳ Paneli i ekranit zbehet.
- ↳ Shfaqet data dhe ora (nëse janë vendosur).



Shënim

- Nëse sistemi nuk punon për 15 minuta, radioja kalon automatikisht në gjendje joaktive.

Për të kaluar te ekrani kryesor:

- 1 Shtypni

- ↳ Në ekran do të shfaqet si më poshtë:



Radio interneti

- 2 Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur opsionet e menisë.

Konfigurimi fillestar

Ndiqui udhëzimet e mëposhtme për të konfiguruar disa parametra bazë.

Për të dëgjuar radio interneti, fillimisht ju duhet një lidhje Wi-Fi. Wi-Fi Protected Setup (WPS) është një standard i krijuar nga Wi-Fi Alliance për krijimin e rrjeteve të sigurta të valëve në shtëpi. Nëse routeri juaj me valë mbështet WPS, mund ta lidhni shpejt dhe në mënyrë të sigurt radion me routerin duke ndjekur një nga dy metodat e konfigurimit. Push Button Configuration (PBC), ose Personal Identification Number (PIN).

Për ata që nuk mbështetin WPS, keni një opsion tjetër për ta lidhur radion me routerin me valë.



Shënim

- Para se të lidheni me një rrjet, njihuni me routerin me valë.
- Sigurohuni që rrjeti Wi-Fi i shtëpisë suaj është i aktivizuar.

- 1 Kur produkti ndizet për herë të parë, do të shfaqet ekrani.


00 / 00 / 0000

00:00

- 2 Shtypni .
- 3 Do të shfaqet [Language].

- Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur gjuhën tuaj të preferuar.

- 4 Do të shfaqet **[Privacy notice]**.
 - Shtypni **[Select]** ose **[OK]** për të konfirmuar.
- 5 Do të shfaqet **[Setup wizard]**.
 - Ndiqni udhëzimet e mëposhtme për të konfiguruar disa parametra bazë.
- 6 Kur shfaqet **[Setup wizard]**,
 - Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur **[YES]** dhe filloni konfigurimin.
 - Shtypni **[Select]** ose **[OK]** për të konfirmuar: Nëse zgjidhni **[NO]**, do t'ju kërkohet të bëni konfigurimin herës tjetër.
- 7 Kur shfaqet **[12/24 hour format]**,
 - Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur formatin 12 ose 24 orë, pastaj shtypni **[Select]** ose **[OK]** për të konfirmuar.
- 8 Kur shfaqet lista **[Auto update]**,
 - Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur metodën e preferuar të orës, pastaj shtypni **[Select]** ose **[OK]** për të konfirmuar.



[Update from DAB]: Sinkronizoni orën me stacionet DAB.

[Update from FM]: Sinkronizoni orën me stacionet FM.

[Update from Network]: Sinkronizoni orën me stacionet e radios së internetit.

↳ Nëse zgjidhet **[Update from Network]**, përsëritni hapin 6 për të vendosur zonën orare, dhe pastaj përsëritni hapin 6 për të vendosur ndërrimin e orës sipas diellit, dhe vendosni nëse produkti do ta mbajë apo jo rrjetin gjithnjë të lidhur.

[No update]: Çaktivizoni sinkronizimin e orës.

↳ Nëse zgjidhet **[No update]**, përsëritni hapin 7 për të vendosur datën dhe orën.

- 9 Kur shfaqet **[Set timezone]**,
 - Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur zonën orare ku ndodhemi.
- 10 Kur shfaqet **[Daylight savings]**,
 - Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur **[YES]** për të përdorur ndërrimin e orës.
 - Shtypni **[OK]** për të konfirmuar.
 - Nëse zgjidhni **[NO]**, do t'ju kërkohet të bëni konfigurimin herës tjetër.
- 11 Kur shfaqet **[Network settings]**,
 - Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur **[YES]** për ta mbajtur rrjetin të lidhur.
 - Shtypni **[OK]** për të konfirmuar.
 - ↳ Radioja fillon të kërkojë automatikisht rrjetet e valëve.
 - ↳ Shfaqet një listë e rrjeteve Wi-Fi të disponueshme.
- 12 Kur shfaqet **[SSID]**,
 - Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur rrjetin.
 - Shtypni **[OK]** për të zgjedhur një opsion për të lidhur routerin tuaj me valë.

Konfigurimi i WPS

Shtypni butonin WPS në routerin tuaj me valë. Shtypni **[Select]** në produkt për të vazhduar.

- **[Push Button]:** Zgjidhni këtë opsion nëse routeri juaj me valë mbështet metodën e konfigurimit WPS dhe PBC. Ju kërkohet të shtypni butonin e lidhjes në routerin tuaj, dhe pastaj shtypni **[OK]** për të vazhduar.
- **[Pin]:** Zgjidhni këtë opsion nëse routeri juaj me valë mbështet metodën e konfigurimit WPS dhe PIN. Radioja gjeneron një kod me 8 shifra, të cilin mund ta vendosni në router.
- **[Skip WPS]:** Zgjidhni këtë opsion nëse routeri juaj me valë nuk e mbështet WPS. Ju kërkohet të vendosni çelësin për rrjetin tuaj Wi-Fi.

- 13 Siç ju kërkohet në ekran, shtypni butonin WPS për të vendosur PIN-in në routerin me valë, ose vendosni çelësin për t'u lidhur me rrjetin (Opsionet që shfaqen varen nga lloji i rrjetit dhe mbrojtja e përdorur).

- Kur vendosni çelësin e rrjetit, për të zgjedhur një karakter, shtypni butonat e navigimit, pastaj shtypni [OK] për të konfirmuar.



- Për të anuluar, shtypni butonat e navigimit për të shkuar te [CANCEL], pastaj shtypni [OK] për të konfirmuar.
- Për ta fshirë regjistrimin, shtypni butonat e navigimit për të shkuar te [BKSP], pastaj shtypni [OK] për të konfirmuar.
- Për të dalë nga procesi, shtypni [MENU]. Nëse rrjeti është krijuar, shfaqet [Connected].

14 Kur shfaqet [Setup wizard completed], shtypni [OK] për të dalë nga konfigurimi.



Shënim

- Për disa routerë Wi-Fi, mund t'ju duhet ta mbani shtypur butonin WPS për lidhjen e Wi-Fi. Shikoni manualin e përdorimit për të parë hollësitë e routerëve specifikë.
- Për të hapur përsëri konfigurimin, zgjidhni menunë [System settings] > [Setup wizard] (shikoni kapitullin "Përdorimi i menues së parametrave të sistemit").

4 Dëgjimi i radios me internet



Shënim


- Sigurohuni që rrjeti Wi-Fi i shtëpisë suaj është i aktivizuar.

Radioja mund të luajë me mijëra stacione radioje nga anembanë bota nëpërmjet lidhjes së internetit.

Përdorni menunë në listën e stacioneve në modalitetin e radios me internet

Pasi të jetë bërë lidhja e internetit, do të shfaqet një listë me stacione. Zgjidhni një për të filluar transmetimin.

- Zgjidhni modalitetin e radios me internet.
 - Radioja fillon të lidhet me rrjetin që ishte lidhur për herë të fundit, dhe pastaj ju çon në stacionin e radios me internet që po dëgjonit për herë të fundit.
 - Nëse lidhja e rrjetit nuk është bërë më përpara, radioja fillon të kërkojë automatikisht rrjetet me valë (Shiko zgjedhjen "Fillimi" > "Konfigurimi fillestar" ose "Përdorimi i menues së parametrave të sistemit" > "Rregullimi i parametrave të rrjetit" për të bërë lidhjen e rrjetit).
- Shtypni  për të hyrë në menunë kryesore.
- Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur opsionet e menues:



[Station list]: Shkoni në çfarëdo stacioni radioje me internet që është i disponueshëm.

[System settings]: Rregulloni parametrat e sistemit (i njëjti opsion menuje për të gjitha

modalitetet. Shiko kapitullin “Përdorimi i menusë së parametrave të sistemit” për hollësi).

[Main menu]: Hyni në menunë kryesore (i njëjti opsion menuje për të gjitha modalitetet. Shiko kapitullin “Përdorimi i menusë kryesore” për hollësi).

- 4 Për të zgjedhur një opsion, shtypni [OK].
- 5 Përsëritni hapat 3 deri në 4 nëse ka ndonjë nën-opsion të disponueshëm poshtë një opsioni.
 - Për t’u kthyer te menuja e mëparshme, shtypni .

[Station list]

[China]: Shkoni në çfarëdo stacioni radioje që është i disponueshëm në Kinë, si për shembull muzikë pop, muzikë klasike, lajme biznesi, e kështu me radhë.

[Stations]

[History]: Shfletoni stacionet e radios me internet sipas historisë.

[Search]: Kërkoni stacione radioje interneti. Për të kërkuar, shtypni butonat e navigimit për të formuar një fjalë kyçe duke zgjedhur karakteret, pastaj shtypni [SELECT].

[Location]: Shfletoni stacionet e radios me internet sipas vendndodhjes.

[Popular]: Shkoni te stacionet më të famshme në internet.

[Discover]: Shkoni te lista e zbulimit për radion me internet.

shtypni [SELECT] për të konfirmuar.

↳ Shfaqet [Preset stored].

↳ Stacioni ruhet në pozicionin e zgjedhur.

Zgjedhja e një stacioni radioje interneti

- 1 Në modalitetin e radios me internet, shtypni [PRESET].
- 2 Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur një numër; pastaj shtypni [SELECT] për të konfirmuar.

Shfaqja e informacioneve të stacionit të radios me internet

Ndërkohë që dëgjoni radio interneti, mbani shtypur [INFO] për të lëvizur nëpër informacionet e mëposhtme (nëse ka):

- Emri i artistit dhe i këngës
- Përshkrim i stacionit
- Zhanri dhe vendndodhja e stacionit
- Codec dhe sampling rate
- Buffer i luajtjes
- Data



Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 15 sekondash, menuja mbyllet.
- Listat e nënstacioneve dhe nënmenutë mund të ndryshojnë herë pas here dhe ato janë të ndryshme sipas vendndodhjeve.

Ruajtja e stacioneve të radios së internetit



Shënim

- Mund të ruani deri në 20 stacione radioje interneti

- 1 Në modalitetin e radios së internetit, shkoni në një stacion radioje interneti.
- 2 Mbani shtypur [PRESET] për 2 sekonda.
 - ↳ Shfaqet lista e stacioneve të ruajtura paraprakisht.
- 3 Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur një numër të ruajtur paraprakisht, pastaj

5 Dëgjimi i Spotify

- Përdorni telefonin, tabletën ose kompjuterin si telekomandë për Spotify.
- Shkoni në www.spotify.com/connect për të mësuar si.
- Softueri Spotify është subjekt i licencave të palëve të treta që gjenden këtu: www.spotify.com/connect/third-party-licenses/

6 Dëgjimi i radios DAB

Kalimi nëpër stacionet DAB

Herën e parë që zgjidhni modalitetin e radios DAB, ose nëse lista e stacioneve është bosh, radioja bën automatikisht një skanim të plotë.

- 1 Shtypni  për të hyrë në menunë kryesore.
- 2 Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur opsionet e menisë, pastaj zgjidhni modalitetin [DAB].
 - ↳ Shfaqet [Scan].
 - ↳ Radioja skanon dhe ruan automatikisht të gjitha stacionet DAB, dhe më pas transmeton stacionin e parë që është i disponueshëm.
 - ↳ Lista e stacioneve ruhet në memorien e radios. Kur të ndizni radion herës tjetër, nuk do të bëhet skanimi i stacioneve.

Për të shkuar në një stacion në listën e stacioneve të disponueshme

Në modalitetin DAB, shtypni butonat e navigimit për të shkuar nëpër stacionet DAB të disponueshme.



Këshillë

- Stacionet mund të ndryshojnë herë pas here. Për të përditësuar listën e stacioneve, zgjidhni menunë [Scan] për të bërë një skanim të plotë.

Ruajtja e stacioneve të radios DAB



Shënim

- Në transmetimet DAB shtohen herë pas here stacione dhe shërbime të reja. Për t'i bërë të disponueshme stacionet dhe shërbimet e reja DAB, bëjeni skanimin rregullisht.
- Mund të ruani deri në 20 stacione radioje DAB.

- 1 Në modalitetin DAB, shkoni në një stacion radioje DAB.
- 2 Shtypni dhe mbani shtypur butonin [PRESET] për më shumë se 2 sekonda.
 - ↳ Shfaqet lista e stacioneve të ruajtura paraprakisht.
- 3 Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur një numër të ruajtur paraprakisht, pastaj shtypni [SELECT] ose [OK] për të konfirmuar.
 - ↳ Shfaqet [Preset stored].
 - ↳ Stacioni ruhet në pozicionin e zgjedhur.

Zgjedhja e një stacioni radioje DAB

- 1 Në modalitetin DAB, shtypni [PRESET].
- 2 Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur një numër, pastaj shtypni [SELECT] ose [OK] për të konfirmuar.

Zgjedhja e menisë DAB dhe shfaqja e informacionit

- 1 Në modalitetin DAB shtypni [MENU] për të hapur menunë DAB.
- 2 Shtypni butonat e navigimit për të ndryshuar opsionet e menisë.



[Station list]: Shfaqni të gjitha stacionet e radios DAB. Nëse nuk gjendet asnjë stacion, radioja fillon të skanojë stacionet DAB dhe t'i shtojë ato në listën e stacioneve.

[Scan]: Skanoni dhe ruani të gjitha stacionet e radios DAB+ të disponueshme.

[Manual tune]: Shkoni manualisht në një stacion DAB+.

[Prune invalid]: Fshini stacionet e pavlefshme nga lista e stacioneve.

[DRC]: Kompresoni gamën dinamike të sinjalit të radios në mënyrë që volumni i tingujve të qetë të

rritet dhe volumi i tingujve të lartë të ulet.

[**Station order**]: Ju jep mundësi të përcaktoni se si organizohen stacionet kur lëvizni nëpër listën e stacioneve.

[**System settings**]: Rregulloni parametrat e sistemit.

[**Main Menu**]: Hapni menunë kryesore (Shiko kapitullin "Përdorimi i menusë kryesore").

3 Për të zgjedhur një opsion, shtypni [**SELECT**] ose [**OK**].

4 Nëse është i disponueshëm një nën-opsion, përsëritni hapat 2-3.

- Për të dalë nga menyja, shtypni [**MENU**] / [**INFO**] përsëri.

[**Prune invalid**]

↳ [**Yes**]: Fshini të gjitha stacionet e pavlefshme nga lista e stacioneve.

↳ [**No**]: Kthehuni te menuja e mëparshme. [**DRC**]

↳ [**DRC high**]: Kalojeni DRC në një nivel të lartë (opsioni standard i rekomanduar për ambientet me zhurmë).

↳ [**DRC low**]: Kalojeni DRC në një nivel të ulët.

↳ [**DRC off**]: Fikeni DRC.

[**Station order**]

↳ [**Alphanumeric**]: Organizojini stacionet sipas rendit alfanumerik (konfigurimi standard).

↳ [**Ensemble**]: Renditni grupet e stacioneve që transmetohen së bashku në të njëjtin ansambël (p.sh.: BBC ose South Wales lokal).



Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 15 sekondash, menuja mbyllet.

Shfaq informacionet e DAB+

Ndërkohë që dëgjoni radio DAB, shtypni vazhdimisht [**MENU**] / [**INFO**] për të shfaqur informacione të ndryshme (nëse ka).

- Emri i stacionit
- Dynamic Label Segment (DLS)
- Fuqia e sinjalit
- Tipi i programit (PTY)
- Emri i ansamblit
- Frekuenca
- Ritmi i gabimeve në sinjal
- Bit-rate dhe statusi i audios
- Codec
- Ora dhe data

7 Dëgjimi i radios FM

Kalimi nëpër stacionet FM

1 Në menunë kryesore, zgjidhni modalitetin [**FM**].

2 Mbani shtypur (◀◀ ose ▶▶) për më shumë se 2 sekonda.

↳ Radioja kalon automatikisht në një stacion radioje FM me sinjal të fortë.

3 Përsëritni hapin 2 për të shkuar në stacione të tjera radioje.

↳ Për të shkuar te një stacion i dobët: Mbani shtypur (◀◀ ose ▶▶) derisa të gjeni një sinjal optimal.

Ruajtja e stacioneve të radios FM



Shënim

- Mund të ruani deri në 20 stacione radioje FM.

1 In Në modalitetin FM, shkoni në një stacion radioje FM.

2 Mbani shtypur [**PRESET**] për 2 sekonda derisa të shfaqet [**Save to Preset**].

3 Shtypni butonat e navigimit për të caktuar një numër 1-20 në këtë stacion radioje, pastaj shtypni [**SELECT**] për të konfirmuar.
↳ Shfaqet [**Preset stored**].

4 Përsëritni hapat 1-3 për të programuar më shumë stacione.



Shënim

- Për ta mbishkruar një stacion të programuar, ruani një stacion tjetër në vend të tij.

Zgjedhja e një stacioni radioje FM të caktuar paraprakisht

- 1 Në modalitetin FM, shtypni [**PRESET**].
- 2 Shtypni butonat e navigimit për të zgjedhur një numër; pastaj shtypni [**SELECT**] për të konfirmuar.

Përdorimi i menusë në modalitetin FM

- 1 Në modalitetin FM shtypni [**MENU**] për të hapur menunë FM.
- 2 Shtypni butonat e navigimit për të lëvizur nëpër opsionet e menusë:



[Scan setting]

[Audio setting]

[System settings]: Rregulloni parametrat e sistemit (shiko kapitullin "Përdorimi i parametrave të sistemit").

[Main menu]: Hapni menunë kryesore (shiko kapitullin "Përdorimi i menusë kryesore").

- 3 Për të zgjedhur një opsion, shtypni [**SELECT**].
- 4 Përsëritni hapat 2-3 nëse ka ndonjë nën-opsion të disponueshëm poshtë një opsioni.
 - Për t'u kthyer te menuja e mëparshme, shtypni [**MENU**].

[Scan setting]

[Strong stations only?]

- ↳ [**YES**]: Skanoni vetëm stacionet e radios FM që kanë sinjal të fortë.
- ↳ [**NO**]: Skanoni të gjitha stacionet e radios FM që janë në dispozicion.

[Audio setting]

[Listen in Mono only?]

- ↳ [**YES**]: Zgjidhni transmetimin mono
- ↳ [**NO**]: Zgjidhni transmetimin stereo

Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 15 sekondash, menuja mbyllet.

Shfaqja e informacioneve RDS

RDS (Radio Data System) është një shërbim që u jep mundësi stacioneve FM të shfaqin informacione shtesë. Nëse dëgjoni një stacion FM me sinjal RDS, do të shfaqet një ikonë RDS, si dhe emri i stacionit.

- 1 Shkoni në një stacion RDS.
- 2 Shtypni [**MENU**] / [**INFO**] vazhdimisht për të shfaqur informacionet e ndryshme RDS (nëse ka):
 - Emri i stacionit
 - Mesazhet e radios
 - Tipi i programit
 - Frekuenca
 - Data

8 Luajtja nga pajisjet me Bluetooth

- 1 Shtypni  për të zgjedhur burimin Bluetooth duke përdorur telekomandën.
 - ↳ Shfaqet [BT].
 - ↳ Treguesi LED i Bluetooth pulson ngjyrë blu.
- 2 Në pajisjen tuaj që mbështet Advanced Audio Distribution Profile (A2DP), aktivizoni Bluetooth dhe kërkonti që pajisjet me Bluetooth që mund të çiftohen (shikoni manualin e përdorimit të pajisjes suaj me Bluetooth).
- 3 Zgjidhni "Philips M2805" në pajisjen tuaj me Bluetooth, dhe nëse është e nevojshme vendosni '0000' si fjalëkalim çiftimi.
 - ↳ Nëse nuk kërkonti dot "Philips M2805" ose nuk mund ta çiftoni me këtë produkt, mbani shtypur  për më shumë se 2 sekonda që të hyni në modalitetin e çiftimit.
 - ↳ Pas çiftimit dhe lidhjes me sukses, treguesi LED i Bluetooth ndizet në ngjyrë blu solide.
- 4 Luani audio në pajisjen e lidhur.
 - ↳ Audio kalon në këtë produkt nga pajisja me Bluetooth.

Për ta shkëputur një pajisje me Bluetooth, çaktivizoni Bluetooth në pajisjen tuaj.




Shënim

- Nuk garantohet pajtueshmëria me të gjitha pajisjet me Bluetooth.
- Çdo pengesë mes kësaj pajisjeje dhe pajisjes suaj me Bluetooth mund ta pakësojë rrezin funksionale.
- Rrezja funksionale e efektshme mes këtij aparati dhe pajisjes me Bluetooth është rreth 10 metra.
- Kjo pajisje mund të ruajë deri në 8 pajisje me Bluetooth, të cilat janë lidhur më parë.

9 Përdorimi i menusë së parametrave të sistemit

- 1 Në modalitetin e punimit shtypni  për të hapur menunë kryesore.
- 2 Shtypni butonat e navigimit për të lëvizur nëpër opsionet e menusë.
- 3 Zgjidhni [System settings], pastaj shtypni [OK] për të konfirmuar.
- 4 Përsëritni hapat 2 dhe 3 për të zgjedhur një opsion.



[Equaliser]: Zgjidhni modalitetin e ekuilizuesit.

[Network]: Ju jep mundësi të krijoni një lidhje rrjeti.

[Time/Date]: Vendosni orën dhe datën.

[Language]: Zgjidhni gjuhën e sistemit.

[Factory Reset]: Rivendoseni radion në statusin standard të fabrikës.

[Software update]: Kontrolloni informacionet e përditësimit të softuerit.

[Setup wizard]: Ju jep udhëzime për të bërë konfigurimin fillestar.

[Info]: Shikoni versionin e softuerit.

[Privacy Policy]: Shikoni njoftimin për privatësinë.

[Backlight]: Rregulloni ndriçimin.



Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 15 sekondash, menuja mbyllet.

Vendosja e gjuhës së sistemit

- 1 Zgjidhni [System settings] > [Language].
↳ Shfaqet një listë e gjuhëve.
- 2 Shtypni butonat e navigimit për të lëvizur nëpër opsionet e menisë.
- 3 Shtypni [SELECT] për të konfirmuar.

Rregullimi i parametrave të rrjetit

- 1 Zgjidhni [System settings] > [Network].
 - 2 Shtypni butonat e navigimit për të lëvizur nëpër opsionet e menisë.
 - 3 Shtypni [SELECT] për të konfirmuar.
- [Network wizard]: Ju jep udhëzime për të krijuar një lidhje rrjeti.

[PBC wlan setup]: Zgjidhni këtë opsion nëse routeri juaj me valë mbështet metodën e konfigurimit WPS dhe PBC.

[View settings]: Shikoni informacionet aktuale të rrjetit.

[Manual settings]

[DHCP enable]: Caktoni automatikisht adresën IP.

[DHCP disable]: Caktoni manualisht adresën IP.

[NetRemote PIN Setup]: Konfiguroni fjalëkalimin e NetRemote.


[Network profile]: Shfaqni një listë rrjetesh që janë në memorien e radios.

[Clear network settings]: Fshini zgjedhjen e parametrave të rrjetit.

[Keep network connected?]: Zgjidhni nëse doni ta mbani apo jo të lidhur rrjetin.

Vendosja e orës dhe datës

- 1 Zgjidhni [System settings] > [Time/Date].
- 2 Shtypni butonat e navigimit për të lëvizur nëpër opsionet e menisë.
- 3 Shtypni [SELECT] për të konfirmuar.



[Set Time/Date]: Vendosni orën dhe datën.

[Auto update]

[Update from DAB]: Sinkronizoni orën me stacionet DAB.

[Update from FM]: Sinkronizoni orën me stacionet FM.

[Update from Network]: Sinkronizoni orën me stacionet e radios së internetit.

[No Update]: Çaktivizoni sinkronizimin e orës.

[Set format]: Vendosni formatin 12/24 orë.

[Set timezone]: Vendosni zonën orare.

[Daylight saving]: Aktivizoni ose çaktivizoni ndërrimin e orës.

Shënimi

- Nëse po e përditësoni orën nga DAB ose FM, opsioni i ndërrimit të orës nuk ka efekt.
- Nëse po e përditësoni nga rrjeti, vendosni zonën tuaj orare.

Rivendosja e të gjitha parametrave

- 1 Zgjidhni [System settings] > [Factory Reset].
 - 2 Shtypni butonat e navigimit për të lëvizur nëpër opsionet e menisë.
 - 3 Shtypni [SELECT] për të konfirmuar.
- [Yes]: Rivendoseni radion në statusin standard të fabrikës.
- [No]: Kthehuni te menuja e mëparshme.

Shikimi i informacioneve të rrjetit dhe përditësimi i firmuerit (nëse ka)

- 1 Zgjidhni [System settings] > [Software update].

2 Shtypni butonat e navigimit për të lëvizur nëpër opsionet e menusë.

3 Shtypni [SELECT] për të konfirmuar.

[Auto-check setting]: Zgjidhni nëse doni të kontrolloni rregullisht nëse ka versione të reja softueri.

[Check now]: Kontrolloni menjëherë versionet e reja të softuerit.



Shënim

- Nëse radioja zbulon se ka softuer të ri në dispozicion, ajo do t'ju kërkojë që të bëni përditësimin. Nëse jeni dakord, softueri i ri do të shkarkohet dhe instalohet. Para se të bëhet përditësimi, sigurohuni që radioja është e lidhur me një burim energjie stabilë. Shkëputja e energjisë gjatë një përditësimi të softuerit mund ta dëmtojë produktin.

Shikimi i versionit të softuerit

1 Zgjidhni [System settings] > [Info].

2 Shtypni butonat e navigimit për të lëvizur nëpër opsionet e menusë.

3 Shtypni [SELECT] për të konfirmuar.

→ Do të shfaqet versioni aktual i softuerit.

Rregullimi i ndriçimit

1 Zgjidhni [System settings] > [Backlight].

2 Shtypni butonat e navigimit për të lëvizur nëpër opsionet e menusë.

3 Shtypni [SELECT] për të konfirmuar.

[Timeout]: Zgjidhni kohën për ndriçimin e ekranit.

[On level]: Zgjidhni një nivel ndriçimi.

[Dim level]: Zgjidhni një nivel ndriçimi, mes mesatar, i ulët dhe i fikur.

10 Përdorimi i menusë kryesore të sistemit

1 Në modalitetin e punimit shtypni  për të hapur menunë kryesore.

2 Shtypni butonat e navigimit për të lëvizur nëpër opsionet e menusë.

3 Zgjidhni [Main menu].

4 Shtypni [OK] për të konfirmuar.

5 Përsëritni hapat 2 dhe 3 për të zgjedhur një opcion.

[Internet radio]: Zgjidhni modalitetin e radios me internet.

[Spotify]: Zgjidhni modalitetin Spotify.

[DAB]: Zgjidhni modalitetin DAB.

[FM]: Zgjidhni modalitetin FM.

[Bluetooth]: Zgjidhni modalitetin Bluetooth.

[Sleep]: Vendosni kohëmatësin e gjumit.

[Alarm]: Vendosni kohëmatësin e alarmit.

[System Settings]: Rregulloni parametrat e sistemit (shiko kapitullin "Përdorimi i parametrave të sistemit").



Shënim

- Nëse nuk shtypet asnjë buton brenda 15 sekondash, menja mbyllet.
- Gjithashtu mund të shtypni butonin e burimit për të zgjedhur një modalitet: Radio interneti, radio DAB, radio FM ose Bluetooth.


Vendosja e orës dhe alarmit

Ky produkt mund të përdoret si orë alarmi.

1 Në modalitetin e punimit shtypni [MENU] për të hapur menunë kryesore.

2 Shtypni butonat e navigimit për të lëvizur nëpër opsionet e menusë.

- 3 Zgjidhni **[Alarms]**.
↳ Nëse nuk është vendosur ora, do të shfaqet një mesazh që ta vendosni.
- 4 Shtypni **[OK]** për të vazhduar.
↳ Shifra e ditës pulson.
- 5 Shtypni butonat e navigimit për të vendosur ditën, pastaj shtypni **[OK]** për të vazhduar.
↳ Shifra e muajit pulson.
- 6 Përsëritni hapin 5 për të vendosur muajin, vitin dhe orën.
↳ Shfaqen opsionet **[Alarm 1: off [00:00]]** dhe **[Alarm 2: off [00:00]]**.



- 7 Përsëritni hapin 5 për të zgjedhur **[Alarm 1: off [00:00]]** > **[Enable]** ose **[Off]**.
- 8 Përsëritni hapin 5 për të aktivizuar ose çaktivizuar kohëmatësin e alarmit:
[Off]: Çaktivizoni kohëmatësin e alarmit.
[Daily]: Alarmi bie çdo ditë.
[Once]: Alarmi bie vetëm një herë.
[Weekends]: Alarmi bie çdo të shtunë dhe të diel.
[Weekdays]: Alarmi bie çdo ditë nga e hëna në të premte.
- 9 Përsëritni hapin 5 për të zgjedhur **[Time]**, pastaj vendosni orën e alarmit.
- 10 Përsëritni hapin 5 për të zgjedhur **[Mode]**, pastaj vendosni burimin e alarmit.
[Buzzer]: Zgjedh sinjalizuesin si burim alarmi.
[Internet radio]: Zgjidhni stacionin e radios së internetit, që keni dëgjuar për herë të fundit, si burim alarmi.
[DAB]: Zgjidhni stacionin e radios DAB, që keni dëgjuar për herë të fundit, si burim alarmi.
[FM]: Zgjidhni stacionin e radios FM, që keni dëgjuar për herë të fundit, si burim alarmi.

- 11 Përsëritni hapin 5 për të zgjedhur **[Preset]**, pastaj zgjidhni stacionin e radios, që keni dëgjuar për herë të fundit, ose një stacion radioje të ruajtur paraprakisht, si burimin e alarmit.
- 12 Përsëritni hapin 5 për të zgjedhur **[Volume]**, pastaj vendosni volumnin e alarmit.
- 13 Përsëritni hapin 5 për të zgjedhur **[Save]**, dhe alarmi 1 vendoset.
- 14 Përsëritni hapin 7 deri në 13 për të vendosur alarmin 2.




Shënim

- Kur aktivizohet alarmi, shfaqet një ikonë alarmi për alarmin 1 ose alarmin 2.
- Për ta ndaluar alarmin, shtypni **ALARM** në produkt.
- Gjithashtu mund të shkoni te **[System settings]** > **[Time/Date]** për të vendosur orën dhe datën (shiko "Përdorimi i menisë së parametrave të sistemit" > "Vendosja e orës dhe datës").

Vendosja e kohëmatësit të gjumit

- 1 Në modalitetin e punës, shtypni **MENU** për të hapur menunë kryesore.
- 2 Shtypni butonat e navigimit për të lëvizur nëpër opsionet e menisë.
- 3 Zgjidhni **[Sleep]**.
- 4 Shtypni butonat e navigimit për të lëvizur nëpër periudhën e kohëmatësit të gjumit (në minuta).
↳ Kur shfaqet **[Sleep OFF]**, kohëmatësi i gjumit çaktivizohet.



11 Informacione për produktin

Shënim

- Informacionet për produktin mund të ndryshohen pa u njoftuar paraprakisht.

Fuqia nominale në dalje (Amplifikatori)	Total 10W RMS
Përgjigja e frekuencës akustike	63 Hz - 20 kHz
Drajveri i boksit	2 x 2,75" reze e plotë, 6 Ω
Përforcimi i basit	2 x portë basi
Protokolli Wi-Fi	802.11 a/b/g/n
Banda e frekuencës Wi-Fi	2412 - 2472 MHz
Fuqia maksimale e transmetimit	15,08 dBm
Versioni i Bluetooth	V4.2
Profillet Bluetooth të mbështetura	A2DPV 1.3, AVRCPV 1.6
Banda e frekuencës Bluetooth / Fuqia në dalje	2402 - 2480 MHz ISM Band / ≤ 4dBm (Class 1)
Rrezja e frekuencave	FM 87,5 - 108 MHz; DAB 174,928 MHz - 239,2 MHz
Stacionet e ruajtura	20
Niveli i hyrjes AUX IN	600 mV +/- 100 mV RMS
Kufje	Xhek 3,5 mm

Energjia

Modeli (adaptor energjie i markës Philips)	AS190-090-AD190
Hyrja	100 - 240 V ~, 50 / 60 Hz, 0,7 A
Dalja	DC 9,0 V, 1,9 A
Konsumi i energjisë gjatë punës	15 W
Konsumi i energjisë në gjendje pritjeje	< 1 W (ora e fikur)
Përmasat	400 x 206 x 100 mm (me mbajtëse)
Pesha	1,7 kg

12 Zgjidhja e problemeve

Paralajmërim

- Asnjëherë mos e hiqni kasën e produktit.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni produktin vetë.

Nëse hasni probleme ndërsa përdorni produktin, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkonti shërbime. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips (www.philips.com/support). Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që pajisja është pranë dhe të kenë gati numrin e modelit dhe numrin e serisë.

Nuk ndizet

- Sigurohuni që kordoni i energjisë AC i pajisjes të jetë lidhur si duhet.
- Sigurohuni që ka energji në prizën AC.
- Si veçori për kursimin e energjisë, sistemi fiket vetë 15 minuta pas luajtja arrin në fund dhe nuk bëhet asnjë veprim.

Nuk ka zë

- Rregulloni volumn.

Telekomanda nuk punon

- Para se të shtypni çfarëdo butoni funksioni, zgjidhni burimin e duhur me telekomandë në vend se njësinë kryesore.
- Afrojeni më shumë telekomandën me pajisjen.
- Vendosini bateritë me polaritetin e duhur, siç tregohet.
- Ndërroni bateritë.
- Drejttojeni telekomandën direkt në sensorin përpara pajisjes.

Marrje e dobët e sinjalit

- Rritni distancën midis aparatit dhe televizorit ose burimeve të tjera të rrezatimit.
- Zgjateni plotësisht antenën e radios.

- Mund ta blini një kablo tjetër antene me spinë me formë L në njërën anë.
- Lidheni spinën me formën L në këtë produkt, dhe montojeni anën tjetër në prizën në mur.



Cilësia e audios është e dobët pas lidhjes me një pajisje me Bluetooth

- Sinjali i Bluetooth është i dobët. Afrojeni më shumë aparatin ose hiqni çdo pengesë mes tyre.
- Pajisja nuk mbështet profilet e nevojshme për këtë aparat.
- Funkzioni Bluetooth i këtij aparati nuk është aktivizuar. Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes për të mësuar se si ta aktivizoni funksionin.
- Ky aparat nuk është në modalitetin e çiftimit.
- Ky aparat është lidhur tashmë me një pajisje tjetër me Bluetooth. Shkëputeni atë pajisje dhe pastaj provoni përsëri.

Pajisja celulare e çiftuar lidhet dhe shkëputet vazhdimisht

- Sinjali i Bluetooth është i dobët. Afrojeni më shumë aparatin ose hiqni çdo pengesë mes tyre.
- Disa telefona celularë mund të lidhen dhe shkëputen vazhdimisht kur bëni ose mbyllni telefonata. Kjo nuk do të thotë se ka ndonjë defekt në këtë aparat.
- Për disa pajisje, lidhja e Bluetooth mund të çaktivizohet automatikisht si veçori për kursimin e energjisë. Kjo nuk do të thotë se ka ndonjë defekt në këtë aparat.

Ora/kohëmatësi nuk punon

- Vendoseni si duhet orën/kohëmatësin.
- Ndizeni kohëmatësin.
- Ora/kohëmatësi është fshirë. Vendoseni përsëri orën/kohëmatësin.
- Është ndërprerë energjia ose kordoni i energjisë është shkëputur.

13 Njoftim

Çdo ndryshim ose modifikim i bërë në këtë pajisje që nuk është miratuar shprehimisht nga **MMD Hong Kong Holding Limited** mund ta bëjë të pavlefshme autoritetin e përdoruesit për ta përdorur produktin.

Deklarata e konformitetit

Këtu, **MMD Hong Kong Holding Limited** deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkesat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.philips.com/support.

Kujdesi për mjedisin

Hedhja e produktit dhe baterisë të vjetër



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri që mbulohen nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative për mjedisin dhe shëndetin e njeriut.

Heqja e baterive njëpërdorimëshe

Për t'i hequr bateritë njëpërdorimëshe, shikoni pjesën për montimin e baterive.

Informacione mjedisore

Të gjitha paketimet e panevojshme janë hequr. Jemi përpjekur ta bëjmë paketimin që të ndahet me lehtësi në tre materiale: karton (kutia), polistirol (amortizuesi) dhe polietilen (qeset, fletë mbrojtëse sfungjeri).

Sistemi përbëhet nga materiale të cilat mund të riciklohen dhe ripërdoren nëse çmontohen nga një kompani e specializuar. Ju lutemi ndiqni rregullat vendëse lidhur me hedhjen e materialeve të paketimit, baterive të konsumuara dhe pajisjeve të vjetra.

Bluetooth®

Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka të regjistruara tregtare që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc. dhe çdo përdorim i këtyre markave nga **MMD Hong Kong Holding Limited** bëhet me licencë. Markat e tjera tregtare dhe emrat e tjerë tregtarë u përkasin pronarëve të tyre përkatës. Softueri Spotify është subjekt i licencave të palëve të treta që gjenden këtu: www.spotify.com/connect/third-party-licenses/

Bërja e kopjeve të paautorizuara të materialeve të mbrojtura, ku përfshihen programet kompjuterike, skedarët, transmetimet dhe regjistrimet me zë, mund të jetë shkelje e të drejtave të autorit dhe mund të përbërë arsye për ndjekje penale. Kjo pajisje nuk duhet të përdoret për qëllime të tilla.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni sistemin vetë. Nëse hasni probleme ndërsa përdorni pajisjen, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkonti shërbime. Nëse problemi mbetet i pazgjidhur, shkoni në faqen e internetit të Philips (www.philips.com/support). Kur kontaktoni Philips, sigurohuni që pajisja është pranë dhe të keni gati numrin e modelit dhe numrin e serisë.

5G WIFI

Veprimet në bandën 5.15-5.35GHz janë të kufizuara vetëm për përdorim të brendshëm. Simboli i ndalimit (piktograma është e rezervuar për kufizim të përdorimit në çdo shtet të BE-së, ju lutemi hiqeni nëse nuk ka kufizim përdorimi në shtetet e BE-së.

Tregohet në paketim ose manual, Paralajmërim kufizimi ose shpjegim i pikës 10 (2) (Të paktën 1 shtet është operacional) dhe 10 (10) informacione në lidhje kufizimet.



BE	BG	CZ	DK	DE	EE
IE	EL	ES	FR	HR	IT
CY	LV	LT	LU	HU	MT
NL	AT	PL	PT	RO	SI
SK	FI	SE	UK		

Bandat e frekuencave dhe fuqia

Ky telefon celular ofron bandat e mëposhtme të frekuencave vetëm në zonat e BE-së dhe fuqinë maksimale të frekuencës radio.

Bluetooth: < 6 dbm

Wi-Fi 2,4 GHz band < 16 dbm

5 GHz band 1~3 < 19dbm

5,8 G band < 7dbm



Specifikimet mund të ndryshohen pa u njoftuar.

2020 © Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka të regjistruara tregtare të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.

TAM2805_00_UM_V1.0

